



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 13/4/prot.  
3

Durrës, më 19/07/2019

VENDIM

Nr 42 , datë 19.07 2019

PËR

**"MIRATIMIN E FINANCIMIT TË PROJEKTIT HISTEK/INTERREG - IPA, NGA TË ARDHURAT E VITIT 2019".**

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e shtetit 2019", Udhëzimit nr. 9, datë 23.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", marrëveshjes së nënshkruar midis përfituesit kryesor "Ministry of Education of Montenegro" (HISTEK) dhe përfituesit partner Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës/Fakulteti i Biznesit, Shkresën nr. 1215 prot., datë 09.07.2019 të Fakultetit të Biznesit, Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19/07/ 2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të shpenzimeve të projektit HISTEK/ INTERREG - IPA, nga buxheti i vitit 2019, i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, si vijon:
  - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë 17 033 762 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
2. Burimi i financimit do të jetë nga të ardhurat e vitit 2019.
3. Shpenzimet e kryera në kuadër të financimit të projektit të sipërcituar do të rimbursohen nga fondet e përfituara nga donatori në kuadër të projektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
  - Administratori
  - Drejtoria e Administrimit Financiar
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**

**Ihrjana ANO**

